

lajmi.net

Zyrtari policor dje u plagos si kalimtar rasti- Dy grupe kishin mosmarrëveshje në Fushë-Kosovë



11/11/2024 08:52

f

t

s

Të shtëna me armë zjarri pati dje në Fushë-Kosovë. Si shkak nga këto të shtëna i plagosur mbeti një person.

I plagosuri në këtë rast është zyrtar policor.

Sipas policisë viktimë mashkull, zyrtar policor jashtë detyrës si kalimtar rasti është plagosur nga dy grupe që kishin mosmarrëveshje mes vete.

“Viktima është dërguar për tretman mjekësor në QKUK. Lidhur me rastin, janë intervistuar dy të dyshuar kosovarë të cilët janë liruar në konsultim me prokurorin, ndërsa një i dyshuar tjetër është arratisur nga vendi i ngjarjes”, thuhet në njoftim.

Njësitë policore me urdhër të prokurorit kanë kryer bastisje në lidhje me rastin, por nuk kanë gjetur asgjë të dyshuar.

Në konsultim me prokurorin kujdestar janë iniciuar veprat e cekura penale si **“VRASJE NË TENTATIVË& SHKAKTIM I RREZIKUT TË PERGJITHSHËM, KANOSJE& ARMËMBAJTJE PA LEJE”**, ndërsa njësitë policore janë duke hetuar rastin./Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM

by LupanMedia

Artikuj të ngjashëm

November 11, 2024

Tahiri gabon në Kuvend “buxheti i katërt në mandatin e katërt”,...

November 11, 2024

Çmimet e ulëta të derivateve në Petrol Company: Mit apo realitet?

November 11, 2024

Armend Muja thotë se Qeveria ka ndarë 5 milionë për çerdhe

November 11, 2024

Kremli: Të pavërteta raportimet për bisedë telefonike mes Trumpit dhe Putinit...

November 11, 2024

Kritika të shumta ndaj buxhetit, Lushtaku: PDK nuk e voton “buxhetin...

November 11, 2024

Gjykimi ndaj Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës nis më...